



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1250 prot.

Tiranë më 19. 10. 2020

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në vijim të shkresës tuaj nr. 4169/21, datë 15.10.2020, nëpërmjet të cilës dërgoni për mendim projektvendimin "*Për miratimin në parim të Marrëveshjes për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit për çështje që lidhen me emigracionin, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Australisë*", Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, konstaton se sugjerimet e dërguara nga ana jonë me shkresat nr. 1331/1, datë 13.09.2019 dhe nr. 188/1, datë 14.02.2020, janë reflektuar në draft – marrëveshjen e dërguar për mendim.

Sa më sipër, projektvendimi vlerësohet i hartuar konform Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

